

BAZAT DHE PARIMET E REPUBLIKES DHE KANTONIT TE NEUCHATELIT

NEUCHATEL

*«Kantoni i Neuchâtel-it është një republikë
demokratike, laike, sociale,
dhe garanton të drejta themelore.»*



MBRRITUR NGA NJË SHTET APO KANTON TJETËR, JU VENDOSINI NË KANTONIN E NEUCHATELIT. E DUKE JETUAR ATJE, PRISNI NJERËZ TË TJERË, TË PORSAARDHUR E TË PORSAARDHURA. CILAT JANË THEMELET E KËTIJ SHTETI QË KENI ZGJEDHUR PËR TË JETUAR ? ÇFARE ËSHTË AJO QË QUHET NJË «REPUBLIKË DEMOKRATIKE, LAIKE, SOCIALE DHE GARANTE E TË DREJTAVE THEMELORE», SIÇ E PËRCAKTON ARTIKULLI I PARË I KUSHTETUTËS SË NEUCHATELIT I 24 SHTATORIT 2000?

HYRJE

Zvicra dhe kantoni i Neuchâtelit, ashtu si edhe kantonet e tjera zvicerane, janë Shtete të bazuara mbi një numër të caktuar parimesh ligjore që shprehin disa vlera dhe e gjejnë origjinën e tyre në historinë e këtij populli e më gjërë, në historinë e Shteteve moderne dhe të mbarë njerëzimit. Këto vlera janë përmbledhur në artikullin e parë të Kushtetutës së Neuchâtelit të 24 shtatorit të vitit 2000, kryeradha e të cilit shpreh qarte:

«Kantoni i Neuchâtel-it është një republikë demokratike, laike, sociale, dhe garanton të drejta themelore.»

Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se kantoni i Neuchâtelit është

- një Shtet që i garanton banorëve të tij liri dhe të drejta themelore (Shtet liberal),
- një Shtet në të cilin populli merr pjesë në formimin e vullnetit dhe në ushtrimin e pushtetit (Shtet demokratik),
- një Shtet që i garanton qytetarëve dhe qytetareve të tij një lloj mbrojtjeje sociale (Shtet social)
- një Shtet në të cilin nuk ka fe Shtetërore (Shtet Laik), por ku mbretëron, nga ana tjetër, liria fetare.

Si për Zvicranët dhe zviceranet, ashtu dhe për të huajt dhe të huajat, nuk është e detyrueshme t'i përkrahin apo mbështesin këto parime dhe vlera, por nga ana tjetër, sejcili prej tyre, e ka sigurisht për detyrë që t'i respektojë ligjet dhe rregullat juridike konkrete të Zvicrës. Ashtu si theksohet qartë edhe nga Gjykata federale: "Shtetasit e vëndeve të tjera që qëndrojnë në Zvicër i nënshtrohen

rendit të njëjtë ligjor ashtu si edhe qytetarët zviceranë. Nga ana tjetër, duke qënë se vijnë nga kultura të tjera, ata s'kanë asnjë detyrim ligjor t'i adoptojnë mënyrës së tyre të jetesës zakonet e Zviceranëve".

Edhe pse nuk është obligim juridik përvehtësimi dhe mbështetja e këtyre vlerave, me qëllim që një Shtet dhe një shoqëri e tillë të funksionojë si duhet, është e domosdoshme që pjesa më e madhe popullsishë t'i njohë e t'i respektojë ato.

Angazhimi për t'i njohur është një përgjegjësi e lirë për sejcilën.

Kjo broshurë ka si qëllim pikërisht t'i shpjegojë dhe ilustrojë parimet dhe bazat e Shtetit liberal, social, demokratik dhe laik që nënkupton ky vënd. Ajo kërkon, po ashtu, t'i prezantojë këto vlera themeluese tek të gjithë ata që vendosen në këtë Kanton, por gjithashtu edhe tek ata që janë vendosur prej kohësh e që mirëpresin të tjerët.

PSE NJË PËRÇAPJE E TILLË ?

Themelet dhe principet e një Shteti janë në përgjithësi të përshkruara në ligjet, të cilat janë rregulla juridike konkrete që çdokush, Zvicerane apo e huaj, është e detyruar t'i respektojë. Edhe nëqoftëse nuk ka asnjë detyrim ligjor që ta detyrojë të njihet me këto parime, duhet megjithatë, që pjesa më e madhe e popullsisë t'i njohë ato, t'i respektojë dhe të angazhohet për t'i mbrojtur, në mënyrë që një Shtet si Neuchâtel të mundet të funksionojë si duhet.

SI PËRCAKTOHET REPUBLIKA DHE KANTONI I NEUCHÂTELIT?

Një Shtet liberal, demokratik, social dhe laik.

Kjo do të thotë që ai u garanton banorëve të tij liri dhe të drejta themelore, se i jep mundësi popullit të ushtrojë pushtetin, sepse u mundëson qytetarëve të tij një mbrojtje sociale dhe se nuk ka fe Shtetërore por liri të garantuar fetare.

«Një Shtet i së drejtës liberale që garanton liri themelore»

NJË SHTET LIBERAL PËRKUFIZIMI

Një Shtet është liberal kur personaliteti njerëzor është në qendër të sistemit të organizimit social dhe i njihet prej Shtetit një sferë pamvarësie, lirie, që materializohet me shprehjen "të drejtat themelore".

- Në qendër të këtyre "të drejtave themelore" ndodhet një e drejtë që është njëkohësisht baza dhe kreu i të gjitha të drejtave të personalitetit të njeriut, **dinjiteti njerëzor**.

Dinjiteti njerëzor, nënkupton të drejtën për të mos qënë i trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese, të drejtën për të qënë i trajtuar si qenie njerëzore dhe jo si një mjet ; Ai përfaqëson bërthamën e paprekshme të lirisë personale dhe të mbron, për shëmbull, nga torturat apo nga çdo lloj trajtimi tjetër mizor apo çnjerëzor.

- Përreth dinjitetit njerëzor, të gjitha "të drejtat themelore" të tjera mund të ndahen në kategori të ndryshme : **liritë** (liritë e sferës personale, liritë e komunikimit dhe liritë ekonomike), **garantuar nga Shteti i së drejtës** dhe të drejtat **sociale**.
- Përpara së të përshkruhen në mënyrë të përmbledhur këto kategori të ndryshme të « të drejtave themelore », duhet theksuar se këto të fundit, dhe veçanërisht liritë, **nuk janë absolute**. Shteti mundet – dhe në disa raste edhe duhet – t'i kufizojë ato. Kjo shpjegohet me faktin se liritë e ndryshme të individëve mund të hyjnë në konflikt midis tyre (liria e shprehjes së disave, për shëmbull, mund të çenojë lirinë e besimeve të disa të tjerëve). Nga ana tjetër, ka raste që krijohen kontradita midis lirisë së individit dhe interesave të bashkësisë : që jeta të bëhet e mundshme në shoqëri, liria e individëve nuk mund të ketë një vlerë absolute (nevojat apo kërkesat e shëndetit publik munden, për shëmbull, të justifikojnë vaksinime apo kontrolle të detyrueshme nëpër shkolla). Ekziston pra një mekanizëm që mundëson kufizimin e këtyre të drejtave, i cili nënkupton konceptin e "limitit". Këto "limite" u nënshtrohen megjithatë kushteve të rrepta. Çdo kufizim, sigurisht që duhet të jetë i arsyetuar dhe i mbështetur në një bazë ligjore, të jetë i justifikuar nga një interes publik ose në shqetësimin për të mbrojtur një të drejtë tjetër themelore, dhe të ketë atë masë, sa të çojë pa dëmtuar në arritjen e qëllimit.

LIRITË

Liritë e **sferës personale** nënkuptojnë, veçanërisht, të drejtën për jetën dhe lirinë vetiake, të drejtën për martesë, të drejtën e ushtrimit të gjuhës si dhe të drejtën e besimit.

E drejta për martesën, për shëmbull, u garanton të gjithë qytetarëve në moshë të rritur të drejtën për tu martuar ashtu si edhe për të vendosur vetë se me cilin duan të martohen. Në mënyrë indirekte, ajo mbron edhe të drejtën e bashkjetesës jashtë kurore. Megjithatë, Kushtetuta mbron vetëm një martesë monogame. Bigamia dhe Poligamia janë të ndaluara me ligj.

Për më shumë, nuk janë të mbrojtur me të drejtën e martesës përveçse ato lidhje, bashkimi i të cilave bëhet midis një burri dhe një gruaje. Megjithatë, çiftet e të njëjtit seks kanë mundësi ta regjistrojnë zyrtarisht jetën e tyre të përbashkët si një "bashkëpunim".

ÇFARË NËNKUPTOJMË ME NJË SHTET TË SË DREJTËS LIBERALE?

Një shtet që garanton të drejtat themelore të njeriut, nga të cilat së pari, dinjitetin njerëzor, që është e drejta për të mos qënë i trajtuar në mënyrë çnjerëzore e poshtëruese; ai del në mbrojtje kundrejt çdo torture e trajtimi tjetër mizor.

A JANË LIRITË TË DREJTA THEMELORE?

Sigurisht që po. Ato kanë të bëjnë me të drejtat e sferës personale, si e drejta e jetës dhe lirisë personale, e drejta e martesës, lirisë së gjuhës dhe asaj të besimit fetar; liritë e komunikimit, që bashkojnë lirinë e mendimit dhe të shprehjes së lirë të tij, lirinë e informimit, lirinë e lidhjes, bashkimit dhe manifestimit; dhe së fundi, liritë ekonomike si dhe lirinë sindikale.

Shteti mund ta bëjë, mbasi disa lloj lirish janë në konflikt midis tyre.

Për shëmbull, liria e shprehjes së disa individëve mund të çenojë, në disa raste, lirinë e besimit tek të tjerët. Ai mundet po ashtu t'i kufizojë ato, në rast se ka kundërshtim midis lirisë së individit dhe interesave të bashkësisë. Por nga ana tjetër, çdo kufizim duhet të bazohet mbi një themel ligjor dhe të justifikohet në emër të interesit publik.

NJË SHTET LIBERAL LIRITË (VAZHDIM)

Liria e gjuhës, për të marrë një shëmbull tjetër, u garanton të gjithë qytetarëve të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre ose asaj të zgjedhur në lidhje me të tjerët, e veçanërisht në mardhëniet e tyre profesionale dhe private, qofshin këto gojore apo me shkrim (ose nëpërmjet gjuhës së shënjave). Në këto mardhënie midis privatëve, si parim, Shteti nuk ndërhyr në zgjedhjen e gjuhës së përdorur. Nga ana tjetër, në raportet midis privatëve dhe Shtetit, ky i fundit mund të përcaktojë një ose disa gjuhë zyrtare, në të cilat ai komunikon me privatët e po ashtu, këta të fundit me të. Liria e gjuhës nuk të jep, nga ana tjetër, një të drejtë të përgjithshme për t'ju drejtuar autoriteteve në çfarëdo lloj gjuhe; caktimi i gjuhëve zyrtare, në parim, kalon mbi lirinë e gjuhës.

Në Zvicër, gjuhët zyrtare të Konfederatës janë gjermanishtja, frëngjishtja dhe italishtja, ashtu si dhe gjuha romanshe, që përdoret në raportet me qytetarët e kësaj gjuhe. Në kantonin e Neuchâtelit, gjuha zyrtare është frëngjishtja. Ligji federal mbi të huajt dhe integrimin (LEI), me qëllim që të ndihmojë integrimin e tyre, e kufizon deri diku lirinë e gjuhës, duke parashikuar që qytetarët e vëndeve të tjera të "familiarizohen me shoqërinë dhe mënyrën e jetesës në Zvicër dhe veçanërisht, që ata ose ato të mësojnë njërën nga gjuhët kombëtare të saj". Në këtë kuadër, Konfederata, kantonet dhe komunat e kanë për detyrë të inkurajojnë mësimin e gjuhës. Për lejet e ndryshme të qëndrimit, nivelet e kërkuara të njohurive gjuhësore të gjuhës zyrtare të vendbanimit përcaktohen me urdhër relativ për pranimin, gjatë qëndrimit dhe ushtrimit të një veprimtarie fitimprurëse (OASA). Në raste të caktuara specifike, marrëveshjet e integritetit mund të imponohen në lidhje me integrimin.

Autoritetet kompetente marrin parasysh gjithashtu shkallën e integritetit dhe njohjen e një gjuhe kombëtare në ushtrimin e gjykimit të tyre, veçanërisht në rast të kthimit, dëbimit ose ndalimit për të hyrë në Zvicër.

Liritë e komunikimit përfshijnë veçanërisht në brëndi të tyre, lirinë e opinionit dhe të shprehjes së lirë, të drejtën për të qënë i informuar, lirinë e lidhjes, bashkimit dhe manifestimit.

Për shëmbull, liria e lidhjes mbron të drejtën e krijimit (ose të shpërndarjes) lirisht të një shoqate, që për dijeni është një grupim i organizuar dhe vullnetar i qytetarëve që ndjekin një qëllim apo një ideal të përbashkët. Po ashtu, kjo liri nënkupton të drejtën e të gjithë qytetarëve për tu antarësuar apo për të marrë pjesë në një shoqatë, por njëkohësisht edhe të drejtën për të mos u antarësuar ose për t'u larguar prej saj.

Nga ana tjetër, liria e lidhjes mbron vetëm ato shoqata që nuk kanë karakter të kundraligjshëm, që do të thotë se qëllimi i tyre (ose mënyrat që përdorin) nuk janë në kundërshtim me rregullin juridik (si për shëmbull, rasti i shoqatave që lançojnë ose përdorin dhunën apo i atyre që paraqesin një kërcënim për Shtetin). Por liria e lidhjes mund të kufizohet, si në kushtet e lartpërmendura, edhe në rastin kur aktiviteti i një shoqate do të çenonte shëndetin ose moralin publik (për shëmbull një sekt që do të vinte në rrezik shëndetin e pasuesve të tij).

Liritë ekonomike, së fundi, përmbledhin garancinë e pronës, lirinë ekonomike, ashtu si edhe lirinë sindikale. Jo të gjithë të huajt dhe të huajat mund të jenë zotërues të garancisë së pronës dhe lirisë ekonomike. Ata-ato mund të jenë të tillë/a vetëm nëqoftëse plotësojnë disa kushte që lidhen sidomos me statusin e qëndrimit të tyre në Zvicër.

GARANCITË E SHITIT TË SË DREJTËS

Pranë këtyre lirive të ndryshme, **garancitë e Shtetit të së drejtës**, që mbështesin po ashtu dinjitetin e njeriut, janë rregulla që kërkojnë nga Shtetit një lloj qëndrimi kundrejt qytetarëve. Mund të përmenden veçanërisht si shembuj, barazia e trajtimit dhe ndalimi i diskriminimeve.

Parimi i *barazisë së trajtimit* si dhe ai i *ndalimit të diskriminimeve* kërkojnë që Shteti të trajtojë në mënyrë të njëjtë atë që është i ngjashëm dhe atë që në një mënyrë tjetër, nuk është i ngjashëm, duke e ndaluar të bëjë dallime që nuk mbështeten në asnjë bazë objektive. Një diferencë trajtimi e dhunon këtë parim ose është diskriminuese nëqoftëse nuk mbështetet mbi një justifikim të arsyeshëm ose mbi një motiv të drejtë. Veçanërisht, *gruaja dhe burri* janë të barabartë ; ata kanë të drejta të barabarta e për këtë arsye duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë. Vetëm subjekte si materniteti mundësojnë, madje kërkojnë një diferencë trajtimi.

TË DREJTAT SOCIALE

Të drejtat sociale, së fundi, u garantojnë individëve disa ndihma financiare prej Shtetit (shih më poshtë, Shteti social).

- Tërësia e gjithë këtyre të drejtave dhe lirive – që themelon liberalizmin – supozon **pluralizmin**, që do të thotë, njohjen dhe pranimin e një shumëllojshmërie dhe të një larmie opinionesh politike, kulturore apo fetare si dhe sjelljesh sociale.
- Nga ana e tij, ky pluralizëm influencon sistemin politik dhe krijon bazën e **demokracisë** liberale.

ÇFARË TË DREJTASH TË TJERA JANË PO ASHTU TË GARANTUARA ?

Parimi i trajtimit të barabartë, ndalimi i diskriminimeve, ashtu si dhe të drejtat sociale që garantojnë disa ndihma financiare prej Shtetit, të domosdoshme për respektimin e dinjitetit njerëzor.

"Në një Shtet demokratik, pushteti i takon popullit"

Ç'ËSHTË NJË SHTET DEMOKRATIK ?

Ai është një Shtet ku pushteti i takon popullit. Por duhet të bëjmë dallime midis regjimeve të demokracisë së përfaqësuar, ku është populli ai që zgjedh përfaqësuesit/et e tij në një Parlament apo në një qeveri, si dhe regjimeve të demokracisë direkte, ku populli mundet edhe më shumë, të ndërhyjë drejtpërsëdrejti me iniciativë dhe referendum. Ky lloj regjimi është në Zvicër dhe në Neuchâtel.

KUSH ZOTËRON TË DREJTA POLITIKE ?

Këto të drejta u janë dhënë shtetasve të të dyja gjinive. Në pjesën më të madhe të vëndeve të tjera, të huajt dhe të huajat janë përjashtuar nga e drejta e shtetësisë. Në Zvicër, në nivelin federal, vetëm qytetarët/et zviceranë/e që kanë mbushur moshën 18 vjeç e zotërojnë këtë të drejtë. Ndërsa kantoni i Neuchâtelit e ka lejuar këtë të drejtë për disa kategori të personave të huaj me Kushtetutën e tij të vitit 2000.

NJË SHTET DEMOKRATIK PËRKUFIZIMI

Një Shtet është *demokratik* kur populli, më saktësisht shtetasit e të dy gjinive, marrin pjesë aktive në formimin e vullnetit shtetëror dhe në ushtrimin e pushtetit.

- Sipas fuqisë së kësaj pjesëmarrjeje, vlerësohet **demokracia e përfaqësuar** nga **demokracia direkte**.
Në një regjim të demokracisë së përfaqësuar, populli zgjedh përfaqësuesit/et e tij që veprojnë në emër të tij ; pushteti është i përqëndruar pra në autoritetet e zgjedhura : Parlamentin dhe në rast nevojë, Qeverinë.
Në një regjim të demokracisë direkte, si në Zvicër dhe në Neuchâtel, shtohet e drejta e pjesëmarrjes së popullit drejtpërsëdrejti në marrjen e disa prej vendimeve. Kjo do të thotë se përveç pjesëmarrjes në zgjedhje, shtetasit dhe shtetasat mund të ndërhyjnë në çështje konkrete, nëpërmjet iniciativës dhe referendumit.
- Pjesëmarrja qytetare e të dy gjinive manifestohet nëpërmjet atyre që quhen **të drejta politike**, të cilat prezantojnë në të njëjtën kohë një të drejtë themelore (të drejtën e pjesëmarrjes në vendimet politike në gjirin e bashkësisë, së cilës ata dhe ato i përkasin) dhe një funksion ose një detyrë (të marrin pjesë në trupin zgjedhor si organ i Shtetit).
- Aktori kryesor i demokracisë pra është **populli**. Megjithatë, ky nocion nuk përfshin politikisht dhe ligjërisht të gjithë banorët/et, por vetëm *shtetasit e të dy gjinive*. Në shumë vënde, *shtetësia* u rezervohet vetëm vëndasve, në një kohë që të huajt përjashtohen prej saj.
 - Po ashtu, në **nivelin federal** në Zvicër, zotërojnë të drejta politike vetëm Zviceranët dhe Zviceranet që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Të huajt dhe të huajat pra, nuk e kanë të drejtën e votës në nivelin federal.
 - Nga ana tjetër, Kantoni i **Neuchâtelit** e ka zgjeruar tradicionalisht përkufizimin e trupit zgjedhor, duke u dhënë të drejtën e votës e po ashtu, të drejtën e të qenit të zgjedhur disa prej kategorive të të huajve e të huajave, posaçërisht me Kushtetutën e tij të re të vitit 2000.

HISTORIA E SË DREJTËS SË VOTËS DHE SË DREJTËS PËR TË QËNË I ZGJEDHUR NË NEUCHÂTEL

- E drejta e votës për të huajt në nivelin komunal ekziston tashmë që prej një kohe të gjatë. Ajo është futur për herë të parë në vitin 1849, pas vendosjes së Republikës, duke u hequr më pas në 1861, për tu rinjohur përsëri në 1875.
- Shtrirja e së drejtës së votes në nivelin *kantonal* është tentuar për herë të parë pa sukses në vitin 1970, për të përfunduar më pas me revizionin total të Kushtetutës, në shtatorin e vitit 2000. Pra, menjëherë pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, në 1 janar 2002, të huajt e të dy gjinive kanë fituar të drejtën e votës në nivel *kantonal*.
- E drejta e zgjedhshmërisë për qytetarët e huaj në Neuchâtel është njohur së pari në vitin 1875, në të njëjtën kohë me rivendosjen e së drejtës së votës, por kjo e drejtë u zhduk trembëdhjetë vjet më vonë, duke mbetur kështu deri në vitin 2007. Gjatë kësaj kohe, një iniciativë dhe një projekt-ligj (1980 dhe 1988) tentoi pa rezultat rivënien e kësaj çështjeje në rend të ditës. Në vitin 2003, një tjetër iniciativë hodhi propozimin që të huajve dhe të huajave tu njëhej e drejta e zgjedhshmërisë si në planin komunal, ashtu dhe në atë kantonal ; në të njëjtën kohë, një kundër-projekt përpunuar nga autoritetet propozonte që kjo e drejtë të njëhej vetëm në planin komunal. Në qershorin e vitit 2007, iniciativa u hodh poshtë në një kohë që kundër-projekti u pranua dhe që prej vitit 2007, qytetarëve të huaj që banojnë në kanton u njihet e drejta për të qënë të zgjedhur në planin komunal.

E DREJTA E VOTES DHE E ZGJEDHSHMËRISË SOT NË NEUCHÂTEL

Për të marrë pjesë në trupin zgjedhor kantonal të Neuchâtelit (pra, për të patur të drejta politike në planin kantonal), duhet të plotësohen tre kushtet e mëposhtme :

- të kesh mbushur moshën 18 vjeç,
- të mos kesh pengesa të shkaktuara nga sëmundje mendore apo dobësi karakteri,
- të jesh i/e kombësisë zvicerane dhe banor/e e kantonit ose, për shtetasit/et e një vëndi tjetër, të jesh i/e paisur me leje qëndrimi të përhershme, sipas të drejtës federale dhe të banosh në kanton së paku prej 5 vjetësh.

Pra me fjalë të tjera, në ditët e sotme, qytetarët e huaj që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe janë të paisur me një autorizim qëndrimi të përhershëm (permis C) munden :

- të votojnë në planin *kantonal*, nëqoftëse banojnë në kanton së paku prej pesë vjetësh;
- të votojnë dhe të zgjidhen në planin *komunal*, nëqoftëse banojnë së paku prej një viti në kanton.

NDËR SHTETASIT - SHTETASET E HUAJ/HUAJA, KUSH MUNDET TË VOTOJË ?

Në Kantonin e Neuchâtelit, ata të huaj që kanë mbushur moshën 18 vjeç e janë të paisur me një autorizim qëndrimi të përhershëm (permis C) munden :

Të votojnë në planin kantonal, pas jo më pak se pesë vjetëve që janë vendosur me banim në kanton.

Të votojnë e të zgjidhen në planin komunal, pas jo më pak se një viti që janë vendosur me banim në kanton.

"Një Shtet social siguron një drejtësi sociale dhe furnizuese"

ÇFARË ËSHTË NJË SHTET SOCIAL ?

Një Shtet social siguron një drejtësi sociale që e shpërndan tek të gjithë. Ai vendos masa sociale, në mënyrë që secili të ketë një formacion, një punë, një banesë të përshtatshme, një mbrojtje sociale (papunësi, pleqëri, sëmundje, aksident). Ai garanton të drejta sociale, të domosdoshme për respektimin e dinjitetit njerëzor, domethënë të drejta për të garantuar kushte minimale të jetesës ashtu si dhe të drejta për një arsim elementar të mjaftueshëm dhe falas.

NJË SHTET SOCIAL PËRKUFIZIMI

Një Shtet është social kur ka autoritetin për të marrë një seri masash sociale,

- Mund të cilësohen si masa sociale, midis të tjerash, ato që i mundësojnë çdo qytetari të përfitojë një formacion, të ketë një vënd pune për të plotësuar nevojat e tij, të jetë i mbrojtur nga pasojat e papunësisë, të gjejë një banesë të përshtatshme, të përfitojë një mbrojtje sociale, veçanërisht në rast pleqërie, sëmundje apo aksidenti.
- Megjithatë, ndërmjet gjithë këtyre masave, duhet bërë dallimi midis atyre që nxjerrin në pah të **drejta** të vërteta **sociale** si dhe atyre që nuk paraqesin përveçse **qëllime** të thjeshta **sociale**.

Të drejtat sociale, ashtu si edhe të gjitha të drejtat e tjera themelore, janë të përligjura në atë kuptim që mund të referohen në mënyrë direkte përpara gjykatave e në të njëjtën kohë, një gjyqtar mund t'i vërë në zbatim pa patur nevojë të marrë aprovim e ligjvënësit. Ato synojnë - në kundërshtim me të drejtat themelore pak më "kalsike" – jo vetëm që të mos abstenohen nga Shteti (respekt për ruajtjen e sekretit të sferës private), por të kenë një mbështetje financiare edhe më të madhe prej tij. Nga ky fakt e duke marrë parasysh mjetet financiare të kufizuara të Shtetit, të drejtat sociale, të përfshira në brendinë e Kushtetutës federale dhe asaj kantonale, janë shumë të reduktuara ; ato kufizohen vetëm në të drejta me të vërtetë thelbësore, duke i mundësuar qytetarit një dalje nga kriza si dhe ushtrimin e të drejtave (të tjera) themelore. Të ardhurat e garantuara nga këto të drejta janë, në një farë mënyre, ato më të domosdoshmet në respekt të dinjitetit njerëzor.

E drejta për të patur kushte minimale jetese, për shëmbull, është një e drejtë e gjykueshme. Ajo u ofron personave që kanë nevojë një garanci minimale, të kufizuar. Në këtë mënyrë, kushdo që ndodhet në një situatë të tillë, ka të drejtën të ketë një banesë, kujdes mjekësor të nevojshëm si dhe mjete të domosdoshme për të ruajtur dinjitetin e tij.

Megjithatë, kjo e drejtë mund të kufizohet nëqoftëse abuzohet me të ose nëqoftëse qytetari e refuzon, për shëmbull, një punë të pranueshme. Kështu, sipas parimit të ndihmës së përkohshme për zgjidhjen e një problemi, Gjykata federale ka vlerësuar se Shteti nuk është i detyruar t'i akordojë një ndihmë materiale qytetarit përkatës, nëqoftëse ai, objektivisht, është në gjendje të sigurojë të ardhura të mjaftueshme, duke pranuar një punë të përshtatshme apo duke marrë pjesë në masa pune ose integrimi, të cilat i refuzon.

Tek të drejtat themelore bëjnë pjesë edhe të drejta të tjera që janë të gjykueshme drejtpërsëdrejti. Këto janë, për shëmbull, e drejta e të miturit për një formacion falas ose e drejta për të qënë i/e mbrojtur dhe i/e asistuar.

Arsimi i mjaftueshëm i bazës është një kusht thelbësor për shanse të barabarta midis të gjithë qytetarëve. *E drejta për një arsim të mjaftueshëm të bazës është falas dhe njëkohësisht e domosdoshme për një shoqëri demokratike. Të gjithë fëmijët që jetojnë në Zvicër, pamvarësisht nga kombësia apo statusi i vëndbanimit të prindërve të tyre, janë zotërues të kësaj të drejte.*

Jashtë këtyre të drejtave sociale, masat e tjera të politikës sociale që janë vendosur nga Shteti, nuk janë të gjykueshme drejtpërsëdrejti, por nënkuptojnë një ndërhyrje të ligjvënës, i cili duhet t'i konkretizojë ato. Në përgjithësi, këto masa sociale kanë po ashtu një karakter të dorës së dytë dhe janë të kufizuara. Në fakt, angazhimi i autoriteteve publike bëhet në kuadrin e mjeteve të mundshme (financiare, sigurisht) dhe në më të shumtën e rasteve, ata ndërhyjnë sipas Kushtetutës, "në plotësim të iniciativës dhe të përgjegjësisë së bashkësive të tjera dhe të personave të veçantë".

"Një Shtet laik nuk njeh besim fetar shtetëror por garanton lirinë e besimit"

SI PËRKUFIZOHET NJË SHTET LAIK?

Është një Shtet ku institucionet publike janë të ndara nga Kishat. Ku nuk ka nje beseim shtetëror fetar, por një regjim që e pranon lirinë e besimit fetar. Kjo liri përfshin lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit, ashtu si edhe lirinë e kulteve. Në emër të kësaj lirie, një komunë e Neuchâtelit nuk mundet t'i ndalojë një nxënseje myslymane mbajtjen e shallit në klasë. Por kjo nuk mund të pranohet për një mësuese, mbasi është në kundërshtim me parimet e neutralitetit konfesional të shkollave publike. Shteti ka për detyrë të jetë i hapur për të gjitha bindjet fetare dhe filozofike. Por kjo nuk e pengon atë tu njohë të tre Kishave të krishtere statusin e institucioneve të interesit public. Kushtetuta e re e Neuchâtelit parashikon mundësinë e shtrirjes së kësaj njohjeje të interesit publik për komunitetet e tjera fetare që e kërkojnë atë.

NJË SHTET LAIK? PËRCAKTIMI

Një Shtet është laik kur Shteti dhe institucionet publike janë të ndara nga Kishat dhe nga komunitetet e tjera fetare. Pra, kur nuk ka fe shtetërore, por një regjim që e pranon lirinë e besimit fetar.

LIRIA E BESIMIT FETAR

Liria e besimit fetar – që nënkupton lirinë e ndërgjegjes dhe besimit ashtu si edhe lirinë e kulteve – është e drejta e të gjithë qytetarëve që të kenë e të praktikojnë, pa ndërhyrjen e Shtetit, një lloj besimi ose një lloj konceptimi të botës dhe të raporteve të njeriut me hyjnoren. Ajo përfshin lirinë për të besuar ose për të mos besuar, për të besuar në disa perëndi ose në një të vetëm (atë të zgjedhjes suaj), për të pohuar besimin ose mosbesimin tuaj, si dhe për të manifestuar fenë ose besimin tuaj, në mënyrë private ose publike. Ajo lejon veçanërisht krijimin e shoqatave fetare si dhe pjesëmarrjen në aktet përkatëse të adhurimit, por edhe të shfaqes së besimit nëpërmjet fjalës, shkrimit, fugurave, muzikës apo veshjeve dhe objekteve fetare.

Si gjithë të drejtat themelore, edhe liria e besimit mund të kufizohet në kushte të zakonshme, që do të thotë, nëqoftëse ky kufizim bazohet në një themel ligjor, nëqoftëse justifikohet nga një interes publik madhor dhe në qoftëse respekton parimin e proporcionalitetit. Megjithatë, edhe pse mund të kufizohet vetëm ajo që lidhet me dukjen e jashtme, aspekti i brëndshëm – e drejta për të krijuar një bindje – duke u konsideruar si vetë esenca e së drejtës themelore, nuk mund të preket në asnjë rast.

Kështu, për shëmbull, në Kantonin e Neuchâtelit, autoritetet kanë gjykuar që komunat nuk mund ta ndalojnë një nxënese myslymane të mbajë shallin në klasë.

Gjykata federale ka menduar, në të kundërt, se ajo nuk do ta lejojë të njëjtën gjë në lidhje me mbajtjen e shamisë islamike nga një mësuese e shkollës publike fillore: ndalimi i kësaj shamie, në këtë rast, nuk është kundër lirisë së besimit, por vetëm për shkak të parimit të neutralitetit konfesional të shkollave publike dhe të Shtetit - të cilin mësuesja e prezanton nëpërmjet funksionit të saj – i cili duhet të qëndrojë mbi lirinë e saj të besimit.

LAICITETI

Principi i lirisë së besimit e implikon Shtetin, në fakt, me një detyrë neutraliteti konfesional, që do të thotë një obligim për hapje të autoriteteve publike kundrejt të gjitha bindjeve fetare dhe filozofike.

Megjithatë, një gjë e tillë nuk e detyron Shtetin të miratojë një qëndrim të lirë në të gjitha aspektet fetare; ai mund të privilegjojë kështu disa komunitete fetare, duke u dhënë atyre njohje të veçantë, pa patur paragjykime për lirinë fetare. Këtë gjë e ka bërë Kantoni i Neuchâtelit, i cili u ka njohur të tre Kishave të krishtere statusin e institucioneve të interesit publik. Edhe pse në këtë rast Shteti nuk duket *krejtësisht* laik, përsëri ai mbetet i shkëputur nga të gjitha bashkësitë fetare, të cilat janë të pavarura. Ky trajtim i diferencuar, i pandarë në çdo status të privilegjuar, shpjegohet në të njëjtën kohë me rëndësinë që ka demografia dhe historia (pjesa më e madhe e popullatës së kantonit është e krishterë, ashtu siç është edhe kultura tradicionale e vendbanimit). Kushtetuta e re e Neuchâtelit parashikon, megjithatë, mundësinë e shtrirjes së kësaj njohjeje të interesit publik për komunitetet e tjera fetare që e kërkojnë një gjë të tillë.

KONKLUZIONE

E TOLERANCA?

Një shtet liberal, social, demokratik dhe laik nënkupton që individët e tij ta pranojnë dhe tolerojnë shumëllojshmërinë e opinioneve. Vetëm toleranca dhe shpirti i hapur mund ta sigurojë ekuilibrin e bashkjetesës midis bashkësive të përzjera.

Si Shtet *liberal, social, demokratik dhe laik*, Zvicra dhe në veçanti kantoni i Neuchâtelit, kërkon tu ofrojë banorëve/eve të saj një numër të caktuar të drejtash; të drejta themelore dhe liri individuale, të drejta politike dhe pjesëmarrje në ushtrimin e pushtetit si dhe të drejta sociale.

Edhe pse nuk ka asnjë detyrim ligjor për respektimin e këtyre parimeve dhe vlerave të një Shteti *liberal, social, demokratik dhe laik*, një Shtet i tillë nuk mund të funksionojë si duhet nëqoftëse pjesa më e madhe e popullsisë së tij nuk i di, nuk i njeh dhe nuk i respekton këto parime dhe vlera. Githkush ka përgjegjësinë e lirë për tu angazhuar që t'i mbrojë ato. Megjithatë, një Shtet i tillë kërkon që individët që e përbëjnë shoqërinë, të pranojnë dhe të tolerojnë larminë dhe pluralizmin e mendimeve dhe ideve. Kështu, për shëmbull, të gjithë ata që e gëzojnë lirinë e besimit fetar, duhet të tolerojë dhe të respektojë po ashtu, lirinë fetare të të tjerëve.

Toleranca dhe mungesa e paragjykimeve: toleranca përcakton aftësinë e një individi për të pranuar diçka me të cilën ai/ajo nuk pajtohet ose që bien në kundërshtim me vlerat e tij/saj. Pra, nëse popujt karakterizohen natyrisht nga ndryshimet midis tyre, është toleranca, çiltërsia, respekti e vlerësimi i pasurisë dhe larmisë së kultuarve, që mund të sjellë ekuilibrin në gjirin e bashkësive të përzjera.

Autorët

Pascal Mahon, profesor i së drejtës kushtetuese
Fanny Matthey, asistent i së drejtës kushtetuese

Katedra e së drejtës kushtetuese – Fakulteti i drejtësisë / Universiteti i Neuchâtelit

Në bashkëpunim me

Shërbimin e Kohezionit Multikulturor (COSM)
Komuniteti për integrim dhe kohezion multikulturor (CICM)

Me mbështetjen e

Etienne Piguet, profesor – Instituti i gjeografisë
Gianni d'Amato, profesor – Instituti SFM

Fakulteti i letërsisë dhe shkencave humane / Universiteti i Neuchâtelit

Përmbledhja

Stéphane Devaux, gazetar

Grafika

Inox Communication SA, Neuchâtel

Fotografitë

Guillaume Perret / Stefano Iori, Ville de Neuchâtel / Bernard Vaucher, Ville du Locle

Botim i 2019

DEPARTAMENTI I EKONOMISË
DHE AKSIONIT SOCIAL
**SHËRBIMI I KOHEZIONIT
MULTIKULTUROR**
Place de la Gare 6
2300 La Chaux-de-Fonds
t +41 (0)32 889 74 42
f +41 (0)32 722 04 04

Konsultoni tekstin e kushtetutës së Neuchâtelit në adresën
www.ne.ch ou www.ne.ch/constitutionNE